VENDIM
Nr.505, datë 13.7.2011

PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE TË SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE, NË QENDRAT REZIDENCIALE, PUBLIKE DHE JOPUBLIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 18 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nxjerr udhëzimin për zbatimin e standardeve dhe të procedurave të ofrimit të shërbimeve në përputhje me to.

3. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha